



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

PROJEKT VENDIM

NR ____ DATË. ____ . ____ .2025

PËR

**“DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NE PERDORIM/QIRA TE SIPERFAQEVE
TE FONDIT PYJOR/KULLOSOR PËR
NDËRTIM PARKU FOTOVOLTAIK”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, Shkonjat “a” dhe “c”, nenit 27, pika 5, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pika 4 dhe 6, nenit 64 shkronja “a” dhe “c”, të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 5, pika 4, të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, Ligji nr.9693 datë, 19.3.2007 “Per Fondin Kullosor”, të ndryshuar, Ligji nr.8480, datë: 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, pikës 52, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433 datë, 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, të ndryshuar, pikës 5 shkronja “ç”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 “ Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vëmprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore e jo drusore pyjore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 27.4.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 559, Udhëzimit nr.1, date 09.06.2016, “ Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit, e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”. Udhëzimit nr.1, date 09.06.2016, “ Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit, e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

I propozojmë këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë dhënie e dakordesise për fillimin e procedurave lidhur me dhënie në përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Kolonje, për ndërtim parku fotovoltaike :

- Sipërfaqes prej **35.21 ha**, në parcelat 93/a me kod KO32 00 093a, sipërfaqe totale **32.49 ha** me cilësim **inproduktiv** , sipërfaqe e kërkuar **11.84 ha**.
- Parcela 1 me kod KO03 00 001 sipërfaqe totale **58 ha** me cilësimin kullotë, sipërfaqe e kërkuar **11.27 ha**.
- Parcela 10 me kod KO03 00 10 sipërfaqe totale **106.17 ha** me cilësimin kullotë miratimin e dhënies së sipërfaqes së kërkuar **12.1 ha** që ndodhet në ekonominë Pyjore/ Kullosore Çlirim në përfundim të fshatit Qafzes pronë e Bashkiake e vërtetuar nga VKM nr. 398 date: 13.05.2020 do përdoren për ndërtim parku fotovoltaike..

1. Për zbatimin e këtij vendimi lidhur me procedurat që parashikojnë aktet ligjore dhe nënligjore, ngarkohet Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, Kryetari i Bashkisë.
2. Vendimi nr. 23, datë 20.02.2025 i Këshillit të Bashkisë Kolonjë, anulohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Konceptoi

Ing. Ervin ÇUKA

Pranoi

Petro KRISTO

**NE MUNGESË DHE ME URDHER
NEN/KRYETAR**

Petro RISTO

KRYETARI

Erion ISAI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr. 1976 prot.

Ersekë më 22/04 / 2025

RELACION

PËR

“DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NE PERDORIM/QIRA TE SIPERFAQEVE
TE FONDIT PYJOR/KULLOSOR PËR
NDËRTIM PARKU FOTOVOLTAIK”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, Shkonjat “a” dhe “c”, nenit 27, pika 5, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pika 4 dhe 6, nenit 64 shkronja “a” dhe “c”, të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 5, pika 4, të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, Ligji nr.9693 datë, 19.3.2007 “Per Fondin Kullosor”, te ndryshuar, Ligji nr.8480, datë: 27.05.1999 “Për funksimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, pikës 52, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433 datë, 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, të ndryshuar, pikës 5 shkronja “ç”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 “ Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vëmprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore e jo drusore pyjore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 27.4.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 559, Ushëzimit nr.1, date 09.06.2016, “ Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit, e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”. Udhëzimit nr.1, date 09.06.2016, “ Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit, e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

1.Të miratojë dhënie e dakordesise për fillimin e procedurave lidhur me dhënie në përdorim/qira të sipërfaqeve te fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Kolonje, për ndërtim parku fotovoltaiik :

- Sipërfaqes prej **35.21 ha**, në parcelat 93/a me kod KO32 00 093a, sipërfaqe totale **32.49 ha** me cilësim **inproduktiv** , sipërfaqe e kërkuar **11.84 ha**.
- Parcela 1 me kiod KO03 00 001 sipërfaqe totale **58 ha** me cilësimin kullotë, sipërfaqe e kërkuar **11.27 ha**.
- Parcela 10 me kod KO03 00 10 sipërfaqe totale **106.17 ha** me cilësimin kullotë miratimin e dhënies së sipërfaqes së kërkuar **12.1 ha** që ndodhet në ekonominë Pyjore/ Kullosore Çlirim në përdorim të fshatit Qafzes pronë e Bashkiake e vërtetuar nga VKM nr. 398 date:13.05.2020 do përdoren për ndërtim parku fotovoltaiik.

Bashkëlidhur relacionit hartat perkatese.

Pas diskutimit nga anëtarët prezentë propozojmë të :

1. Te miratohet dhenia e dakordesise për fillimin e procedurave lidhur me dhënien përdorim/qira të sipërfaqeve të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Kolonje, për ndërtim parku fotovoltaik : të evidentuara ketu me lart ne piken 1. te ketij Relacioni .
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve , Parqeve dhe Rekreacionit dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Konceptoi

Ing. Ervin ÇUKA

Pranoi

Petro KRISTO

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

NËN/KRYETAR

Petro RISTO

K R Y E T A R I

Erion ISAI